



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	18.01.2024
REFERENC-Ë:	23/4197/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Eperme-Gllogoc Ekspluatim i gurit gëlqeror ne Korroticë- Drenas
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Eperme- Gllogoc, me Nr. Prot. 23/4197/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Eperme- Gllogoc, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror ne Korroticë- Drenas; dhe
- Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/4197/MMPHI
Datë: 18.01.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit për Pëlqim Mjedisor me Nr. 03/3040/3/ZSP-342 të lëshuar me dt. 07.05.2004, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore te dt. 09.11.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Eperme- Glllogoc, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror ne lokacionin e cekur ne Licencën e Shfrytëzimit nga KPMM me nr. 2069/KPMM/2020 te protokolluar me nr. 1367, te lëshuar me dt. 09.03.2020, në Licencë për Shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 2070/KPMM/2020, të protokolluar me nr. 1366, të lëshuar me dt. 09.03.2020, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 02.03.2030 dhe në Licencë për Shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 563/ICMM/2006, të protokolluar me nr. 314, të lëshuar me dt. 11.10.2010, me afat te vlefshmërisë deri me dt. 10.07.203, në zona kadastrale "Kroni i Mbretit" ne Korroticë të Eperme.

Operatori obligohet:

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; <https://mmphi.rks-gov.net/>



- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Vlerat e cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.3. Raporti i rezultateve të cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPHI-së;
- 2.4. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror;
- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.6. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.7. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të beje rehabilitimin dhe ri kultivimin e zonës se eksploatimit.

Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtë vendimi.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Eperme- Glllogoc, është konstatuar se Operatori për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror ne lokacionin e cekur ne Licencën e Shfrytëzimit nga KPMM me nr. 2069/KPMM/2020 te protokolluar me nr. 1367, te lëshuar me dt. 09.03.2020, në Licencë për Shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 2070/KPMM/2020, të protokolluar me nr. 1366, të lëshuar me dt. 09.03.2020, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 02.03.2030 dhe në Licencë për Shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 563/ICMM/2006, të protokolluar me nr. 314, të lëshuar me dt. 11.10.2010, me afat te vlefshmërisë deri me dt. 10.07.203, në zona kadastrale "Kroni i Mbretit" ne Korroticë të Epërme, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne dispozitiv është përcaktuar, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Drenas;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure


Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	23/4197/413/MMPHI-DMMU
DATË/A:	18.01.2023
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMMU-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatlije Buza, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Epërme-Gllogoc Eksplotim i gurit gëlqeror ne Korroticë- Drenas

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokolli: 23/4197/413/MMPHI-DMMU, të operatorit "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Epërme- Gllogoc, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror ne Korroticë- Drenas.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu /
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:	23/4197/413/ MMPHI-DMMU				
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI				
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Komisioni për Leje Mjedisore				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ne kërkesën e operatorit "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Epërme- Glllogoc Eksplotim i gurit gëlqeror ne Korroticë- Drenas				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1517	Lokacioni: Kucni: Extension:	Ish pallati i mediave Rilindja, Prishtinë.	Data: Datum: Date:	18.01. 2024
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input checked="" type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 7416/23, të dt. 22.12.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L- 025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 8 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "Trasing Group" SH.P.K. Korroticë e Epërme- Glllogoc, ka aplikuar me Nr. Prot. 23/4197/413/MMPHI-DMMU për vazhdimin e Lejes Mjedisore me Nr. 17/396/ZSP/91/18 të lëshuar me dt. 30.03.2018, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror ne lokacionin e cekur ne Licencën e Shfrytëzimit nga KPMM me nr. 2069/KPMM/2020 te protokolluar me nr. 1367, te lëshuar me dt. 09.03.2020, në Licencë për Shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 2070/KPMM/2020, të protokolluar me nr. 1366, të lëshuar me dt. 09.03.2020, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 02.03.2030 dhe në Licencë për Shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 563/ICMM/2006, të protokolluar me nr. 314, të lëshuar me dt. 11.10.2010, me afat te vlefshmërisë deri me dt. 10.07.203, në zona kadastrale "Kroni i Mbretit" ne Korroticë të Epërme, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr. 03/3040/3/ZSP-342 të lëshuar me dt. 07.05.2004.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 03/3040/3/ZSP-342 të lëshuar me dt. 07.05.2004;
- Leje Mjedisore me Nr. 17/396/ZSP/91/18 të lëshuar me dt. 30.03.2018;
- KPMM- Licencë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 2069/KPMM/2020, të protokolluar me nr. 1367, të lëshuar me dt. 09.03.2020, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 02.03.2030;
- KPMM- Licencë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 2070/KPMM/2020, të protokolluar me nr. 1366, të lëshuar me dt. 09.03.2020, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 02.03.2030;
- KPMM- Licencë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, me nr. 563/ICMM/2006, të protokolluar me nr. 314, të lëshuar me dt. 11.10.2010, me afat te vlefshmërisë deri me dt. 10.07.2031;
- Komuna E Drenasit- Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik- Aktvendim me nr. 04-352-32170, te lëshuar me dt. 05.06.2017;






Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar vizite te operatori, për verifikimin e kushteve mjedisore me dt. 22.09.2023.

Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës te operatorit në fjalë duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin përcjellës qe nevojitet për pajisje me leje mjedisore dhe gjendjes faktike në teren, në takimin e mbajtur me dt. 18.01.2024, në përbërje prej tre (3) anëtareve, unanimisht, kanë dhen mendim profesional si ne vijim:

Operatori i ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori i ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore dhe si përfundim Komisioni rekomandon që ti lëshohet Leja Mjedisore.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për Leje Mjedisore.

Komisioni:

Fatlje Buza, kryesuese	
Adem Tusha, anëtar	
Përparim Terziu, anëtar	
Fatmir Bytyqi, anëtar	<u>Gjendet ne pushim mjekësor.</u>
Mentor Shala, anëtar	<u>Nuk ka qene prezent ne takim.</u>

